

## Vendim nr. 132 datë 12.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 12.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** VALENTINA TROJA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 3327(80-2016-3351), datë 27.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2551, datë 07.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-318, datë 18.01.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja Valentina Troja rezulton bashkëpronare (në 3/5 pjesë) së bashku me familjarët e saj L.T. e R.T. (të paditur në gjykim) e pasurisë apartament, me sipërfaqe 61,3 m<sup>2</sup>, në qytetin e Tiranës. Për nevoja strehimi, pa lejen e organeve kompetente, apartamentit i është bërë një shtesë anësore. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (ligji nr. 9482/2006), shtetasja L.T. ka aplikuar për legalizimin e shtesës anësore të apartamentit, duke plotësuar formularin e vetëdeklarimit për objektin informal. Me pretendimin se në formularin e vetëdeklarimit duhet të përfshihej edhe emri i saj, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e palës së paditur, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale (ALUIZNI), Drejtoria Tirana 2, për ta përfshirë në procedurat e legalizimit për llogari të formularit të vetëdeklarimit si kontribuese në 3/5 pjesë për sipërfaqen 29 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katin e tretë të shtesës së deklaruar për legalizim. Ajo ka kërkuar edhe vënien në dispozicion të një kopjeje të praktikës së legalizimit, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e procedurës së mëtejshme të legalizimit.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3327(80-2016-3351), datë 27.06.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se vetëm pasja e pronësisë së objektit ngjitur me shtesën informale nuk është e mjaftueshme për t’u njohur kërkuesja si bashkëkontribuese në ndërtimin informal, për më tepër në kuotën e 3/5-ve të ndërtimit, ndërsa ky i fundit është realizuar mbi truall shtetëror. Sipas gjykatës, kërkuesja nuk ka arritur të provojë se ka kontribuar për ndërtimin e shtesës anësore të apartamentit, në kushtet kur ka të ardhura minimale, për më tepër, ajo rezulton t’i ketë kërkuar Bashkisë Tiranë prishjen e ndërtimit pa leje. Për të gjitha këto, gjykata ka vlerësuar se pretendimet e paditëses (kërkueses) janë të pabazuara.

3. Mbi bazën e ankimit të kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2551, datë 07.06.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-318, datë 18.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se në të nuk parashtrohen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar dhe se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të parimeve të gjykimit administrativ, si dhe kërkesave të ligjit procedural. Sipas këtij kolegji, të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese

nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të ligjit material që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim.

4. Në datën 09.04.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.04.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuases

5. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar si vijon:

5.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

5.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjyqtarja relatore e çështjes në Gjykatën e Lartë ka konflikt interesi, për shkak se në vitin 2004 ka qenë e punësuar si juriste në Bashkinë Tiranë, së bashku me të paditurën në gjykim.

5.1.2. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për njësimin e praktikës gjyqësore.

5.2. *Të drejtën e pronës*, pasi ajo është zhveshur nga prona nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara, të vërtetuara nga ekspertiza grafike e Policisë Shkencore, dhe megjithëse për këtë fakt ajo ka paraqitur kallëzim, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuases*

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë

të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

7. Kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

8. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

9. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 18.01.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 09.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të paanshmërisë, mospranimit nga Gjykata e Lartë të kërkesës për njësimin e praktikës gjyqësore, si dhe së drejtës së pronës. Duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuëses për të drejtën e pronës lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, Kolegji çmon t’i analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

11. Për sa i takon pretendimit se Gjykata e Lartë nuk ka pranuar kërkesën për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vëren se kërkuësja nuk ka sjellë asnjë argument në mbështetje të tij, duke mos arritur të provojë cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese, prandaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, Kolegji vlerëson se *prima facie* hyn në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohet në vijim.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë*

13. Kërkuësja ka pretenduar se gjyqtarja relatores e çështjes në Gjykatën e Lartë ka konflikt interesi, për shkak se në vitin 2004 ka qenë e punësuar si juriste pranë Bashkisë Tiranë, së bashku me të paditurën në gjykim.

14. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmëri e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 6, datë 29.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtarës relatores në Gjykatën e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë konstatohet se kërkuësja i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës relatores, e cila është shqyrtuar dhe me vendimin e gjyqtarit të vetëm është disponuar për pabazueshmërinë e saj (*shih paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Duke iu referuar argumenteve të ngritura në ankimin kushtetues, Kolegji vlerëson se vetëm fakti se gjyqtarja relatores ka qenë e punësuar pranë Bashkisë së Tiranës, rreth 20 vjet më parë, nuk mund të vendosë në dyshim *a priori* paanshmërinë e saj në drejtim të bindjes së brendshme për zgjidhjen e çështjes konkrete të kërkuësës. Për më tepër, kërkuësja nuk ka paraqitur asnjë argument për të provuar shkeljen reale të kësaj të drejte, si në aspektin e testit subjektiv, ashtu dhe të atij

objektiv, të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson ky pretendim është haptazi i pabazuar.

17. Për sa më lart, në kushtet kur pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor, të ngritur nga kërkuesja në drejtim të parimit të paanshmërisë janë haptazi të pabazuara, për rrjedhojë edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës, i ndërvarur nga procesi, është haptazi i pabazuar.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.